



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
Jedinica za upravljanje ljudskim resursima / Human Resources Management Unit

Datë: 27/08/2024

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NJBNI) në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në pajtim me nenin 16 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë Në mbështetje të nenit 53 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/ L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerrë këtë:

VENDIM

Për Anulimin e Konkursit

1. Anulohet, konkursi për pozitën Drejtor Ekzekutiv me nr.ref RN00014581 i Publikuar në Sistemin për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNI) me datë 19/07/2024

Arsyetim

Anulimi i konkursit për pozitën Drejtor Ekzekutiv, bëhet për shkak se ne fazën e verifikimit paraprak prej katër (4) aplikuarve për pozitën e lartpërmendur vetëm një(I) kandidatë i plotëson kushtet dhe kriteret e konkursit(e ka kaluar verifikimin paraprak).

Sipas legjislacionit aktual në fuqi, pranimi në pozitë të lartë drejtuese behet me konkurs të hapur dhe publik. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza:

- Verifikimi paraprak. përmes së cilit verifikohet nëse kandidatet/et plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit: dhe
- Vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve/eve.

Po ashtu sipas legjislacionit në fuqi në rast se procedura e rekrutimit përfundon pa të paktën dy (2) kandidat/at fitues të vlerësuar mbi pragu minimal të shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, organizohet procedura e re rekrutimi.

Ne mungesë të konkurrencës prej dy kandidatëve procedura e rekrutimit ndërpritet dhe rrjedhimisht nuk janë krijuar kushte ligjore për të vazhduar rekrutimi në fazën tjetër.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

